

**ITX ALBANIA SH.P.K.**

**Raporti i Audituesit të Pavarur dhe  
Pasqyrat Financiare më dhe për  
vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

**PËRMBAJTJA**

	<b>FAQJA</b>
<b>RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR</b>	
<b>PASQYRAT FINANCIARE:</b>	
<b>PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR</b>	<b>3</b>
<b>PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA     PËRMBLEDHËSE</b>	<b>4</b>
<b>PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN AKSIONAR</b>	<b>5</b>
<b>PASQYRA E RRJEDHJËS SË PARASË</b>	<b>6</b>
<b>SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE</b>	<b>7-25</b>

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

### Drejtimit dhe Aksionarëve të ITX Albania sh.p.k.

#### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të ITX Albania sh.p.k. të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave bazë kontabël dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të ITX Albania sh.p.k. më 31 dhjetor 2017, si dhe performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Nderkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

#### Bazat për Opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Nderkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e seksionit të Pasqyrave Financiare të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Standardet Nderkombëtare të Kodit të Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodi SNKEBK) sipas kërkesave etike, të cilat janë të rëndësishme për auditimin e pasqyrave financiare, gjithashtu dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kërkesat tona dhe Kodin SNKEBK.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

#### Përgjegjësia e Drejtimit dhe Palëve të Ngarkuara me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që percaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, manaxhimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur manaxhimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndalojë operacionet ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale se përveçse më lart.

Palët e Ngarkuara me Qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

#### Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touche Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see <http://www.deloitte.com/al/about> for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touche Tohmatsu Limited and its member firms.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie material, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë edhe informacionin e ofruar në shënimet shpjeguese, me qëllim për të pasqyruar nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë transaksionet dhe ngjarjet e periudhës kontabël, për efekt të këtij raporti.

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Shoqërisë, ku përveçse çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikuar gjatë auditimit tonë.

*Deloitte Audit Albania sh.p.k.*

Deloitte Audit Albania sh.p.k  
Rr. Elbasanit, Pallati poshte Fakultetit Gjeologji - Miniera,  
Tirana, Albania  
Identification number (NUIS): L41709002H

*Elvis Ziu*  
Auditues ligjor  
Elvis Ziu



March 30, 2018  
Tirana, Albania



	Shënime	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
<b>AKTIVET</b>			
<b>Aktivët Afatshkurtra</b>			
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	5	663,947	535,705
Inventari	6	213,135	192,138
Aktive të tjera	7	7,666	9,521
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>884,748</b>	<b>737,364</b>
<b>Aktivët afatgjata</b>			
Aktive afatgjata materiale	8	673,810	749,676
Aktivët afatgjata të tjera	9	21,556	15,808
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>695,366</b>	<b>765,484</b>
<b>Totali i Aktiveve</b>		<b>1,580,114</b>	<b>1,502,848</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrimet Afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme	10	59,693	62,588
Huamarrje nga palet e lidhura		-	-
Të ardhura të shtyra	11	29,670	29,670
Detyrime të tjera	12	149,468	112,056
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>238,831</b>	<b>204,314</b>
<b>Detyrimet Afatgjata</b>			
Të ardhura të shtyra	11	304,118	333,789
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>304,118</b>	<b>333,789</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>542,949</b>	<b>538,103</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali Aksionar		400,000	400,000
Rezerva		-	-
Humbjet e akumuluar		-	-
Fitimi/(Humbja) i pashpërndarë		637,165	564,745
<b>Totali i Kapitalit</b>		<b>1,037,165</b>	<b>964,745</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>1,502,848</b>	<b>1,502,848</b>

Pasqyra pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7 deri në 25, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare janë aprovuar dhe firmosur më 29 mars 2018:

Ana Rogic  
Administrator



Jonida Shahu  
Manaxhere finance

**ITX Albania Sh.p.k.**

**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**


*(Shumat janë shprehur në mijë LEK)*

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	
Të ardhura nga shitjet	13	3,061,681	2,540,136
Të ardhura të tjera		37,499	37,170
<b>Totali i të ardhurave</b>		<b>3,099,180</b>	<b>2,577,306</b>
<b>Kosto e shitjeve</b>			
Kostot e produkteve të shitura		(1,580,813)	(1,264,081)
<b>Totali i kostos së shitjeve</b>		<b>(1,580,813)</b>	<b>(1,264,081)</b>
<b>Shpenzime</b>			
Shpenzime personeli	16	(164,142)	(151,905)
Shpenzime page		(143,424)	(133,568)
Shpenzime sigurime shoqërore dhe shëndetësore		(20,718)	(18,337)
Shpenzime amortizimi dhe zhvlerësimi i aktiveve materiale dhe jomateriale	8	(109,037)	(116,476)
Shpenzime të tjera operative	14	(487,566)	(375,048)
<b>Të ardhura nga aktiviteti operativ</b>		<b>757,622</b>	<b>669,796</b>
<b>Të ardhura dhe shpenzime financiare</b>			
Të ardhura financiare	15	5,372	5,430
Shpenzime financiare	15	(9,795)	(7,133)
<b>Totali shpenzimeve financiare</b>		<b>(4,423)</b>	<b>(1,703)</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>753,199</b>	<b>668,093</b>
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	17	(116,034)	(103,348)
<b>Fitimi neto i vitit</b>		<b>637,165</b>	<b>564,745</b>

*Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7 deri në 25, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.*

Pasqyrat financiare janë aprovuar dhe firmosur më 29 mars 2018 nga:

Ana Rogic  
Administrator




Jorida Shahu  
Manaxhere finance



ITX Albania Sh.p.k.

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin aksionar më 31 dhjetor 2017


Shumat janë të shprehura në mijë LEK)

	Kapitali i rregjistur dhe i paguar	Humbjet e akumuluar	Totali
<b>Gjendja më 1 Janar 2016</b>	400,000	437,188	837,188
Dividend të paguar	-	(437,188)	(437,188)
Fitimi i vitit		564,745	564,745
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2016</b>	<b>400,000</b>	<b>564,745</b>	<b>964,745</b>
<b>Gjendja më 1 Janar 2017</b>	400,000	564,745	964,745
Dividend të paguar		(564,745)	(564,745)
Fitimi i vitit		637,165	637,165
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>400,000</b>	<b>637,165</b>	<b>1,037,165</b>


*Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit aksionar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7 deri në 25, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.*

Pasqyrat financiare janë aprovuar dhe firmosur më 29 mars 2018 nga:

Ana Rogic  
Administrator



Jonida Shahu  
Manaxhere finance



**ITX Albania Sh.p.k.**

**Pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

*(Shumat janë shprehur në mijë LEK)*


	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Fitimi/(Humbja) neto para tatimit	637,165	564,744
<i>Rregullime për:</i>		
Zhvlerësimin dhe amortizimin e aktiveve afatgjata	109,037	116,476
Shpenzime tatim fitimi të njohura në fitim ose humbje	116,034	103,349
Shpenzimet financiare të njohura në fitim ose humbje		417
Kembimi valutor	(4,423)	-
<i>Ndryshimet ne kapitalin punues:</i>		
Rritje /( Rënie) në llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera	1,855	22,286
Rritje /( Rënie) në inventar	(20,997)	(54,431)
Rritje /(Rënie) e të ardhurave të shtyra	(29,671)	(29,671)
Rritje /( Rënie) në llogaritë e pagueshme dhe të tjera	34,517	38,886
Interesi paguar		
Tatim fitimi i paguar	(121,782)	(109,049)
<b>Paraja neto gjeneruar nga aktivitetet operative</b>	<b>721,735</b>	<b>652,591</b>
<b>Rjedhja e parasë nga aktivitetet investuese</b>		
Blerje aktivesh afatgjata materiale	(33,171)	(17,385)
<b>Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese</b>	<b>(33,171)</b>	<b>(17,385)</b>
<b>Rrjedhja e parasë nga veprimtaritë financuese</b>		
Dividendët e paguar	(564,745)	(437,188)
<b>Paraja neto e përdorur në veprimtaritë financuese</b>	<b>(564,745)</b>	<b>(437,188)</b>
<b>Rritje neto në mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre</b>	<b>123,819</b>	<b>198,630</b>
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre në 1 Janar	535,705	337,075
Efekti i kursit të kembimit mbi mjetet monetare dhe ekuivalentet në monedhe të huaja	4,423	131
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në 31 Dhjetor</b>	<b>663,947</b>	<b>535,705</b>

*Pasqyra e rrjedhjes së parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7 deri në 25, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.*

Pasqyrat financiare janë aprovuar dhe firmosur më 29 Mars 2018 nga:

Ana Rogic

Administrator




Jonida Shahu

Manaxhere finance





## **1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM**

ITX Albania Sh.p.k. ("Shoqëria") u krijua si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më datë 27 nëntor 2013. Vendndodhja kryesore e aktivitetit është në Tiranë, Shqipëri. Shoqëria zotërohet 100% nga Zara Holding BV ("shoqëria mëmë"). Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga 100 aksione me vlerë 400,000 LEK secili.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është shitja e produkteve të modës nëpërmjet dyqaneve me pakicë. Shoqëria aktualisht po manaxhon pesë dyqane të markave të ndryshme: Zara, Bershka, Stradivarius, Pull & Bear dhe Massimo Dutti, të cilat ndodhen në qendrën tregtare Tirana East Gate ("TEG") në Lundër, Tirane, Shqipëri që nga data 16 prill 2014.

Më 31 dhjetor 2017, Shoqëria kishte 234 punonjës (31 dhjetor 2016: 187 të punësuar).

## **2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE**

### **2.1 Deklarata e përputhshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Në vitin aktual, Shoqëria ka adaptuar SNRF për herë të parë. Rrjedhimisht, adaptoi të gjitha standardet dhe interpretimet që ishin në fuqi në datën e kalimit, 1 janar 2014. Rregullat e adaptimit për herë të parë të SNRF janë të përcaktuara në SNRF 1 "Adoptimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar". Më 1 janar 2014, data e tranzicionit, hapja e pasqyrës së pozicionit financiar sipas IFRS është bërë në përputhje me SNRF 1, e cila kërkon që politikat kontabël sipas SNRF-ve të zbatohen në bazë retrospektive, me përjashtime të caktuara.

#### **a) Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Në përputhje me Ligjin nr.9228, " Mbi Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, këto pasqyra financiare janë përgatitur dhe paraqitur në Lekë, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

#### **b) Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël**

Ndryshimet në vlerësimet kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe jo në mënyrë retrospektive. Informacion i mëtejshëm është paraqitur në politikat kontabël 3 (a) (iii) dhe 3 (b) dhe shënimet 8 dhe 9.

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të bëjë gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga ai i vlerësuar.

## **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL**

Politikat kryesore janë renditur më poshtë.

### **a. Aktive Afatgjata Materiale**

#### *(i) Njohja dhe vlerësimi*

Aktivitet Afatgjata Materiale janë paraqitur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar. Kosto e tillë përfshijnë shpenzimet që lidhen drejtpërdrejtë me blerjen e asetit.



**3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)****a. Aktive Afatgjata Materiale (vazhdim)**

Kostot për ndërtimin vetë të nje aktivi përfshijnë kostot për materialet dhe mjetet e përdorura në ndërtimin aktivitet, kostot e punës (pagat, tatimet dhe kontributet përkatëse paguar punonjësve në lidhje me ndërtimin e aktivitet) dhe çdo kosto e drejtpërdrejtë e nevojshme për ta sjellë aktivin në kushtet e nevojshme për funksionimin e tij.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit i një zëri të aktiveve afatgjata përcaktohen duke krahasuar të ardhurat nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël të aktivitet dhe njihen neto në të ardhurat e tjera në pasqyrën e të ardhurave.

*(ii) Kostot vijuese*

Kostot që kanë të bëjnë me përmirësimet e mëpasshme dhe kostot e zëvendësimit të një pjese të aktivitet i shtohen kostos së AAM-së vetëm nëse ato marrin pjesë në gjenerimin e përfitimeve të ardhshme ekonomike për shoqerine.

Kostot që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen në paqyren e humbje/fitimit kur ato ndodhin.

*(iii) Amortizimi*

Vlera e amortizueshme e një zëri të AAM-së njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, duke përdorur metodën lineare për të gjitha aktivitet materiale mbi jetëgjatësinë e vlerësuar të çdo pjesë të aktivitet afatgjatë që prej ditës së parë të muajit pasues të muajit të blerjes.

Normat e amortizimit të përdorura nga shoqëria janë si më poshtë:

<b>Kategoria e Aseteve</b>	<b>Metoda e amortizimit</b>	<b>Norma e amortizimit</b>
Mobilje dhe Instalime	Metoda lineare	11.11%
Pajisje Elektronike	Metoda lineare	20.00%
Përmirësimet e objekteve me qira lidhura me dyqane	Metoda lineare	11.11%
Përmirësimet e objekteve me qira në lidhje me zyrën	Metoda lineare	35.23%

Vlera e mbetur, jeta e dobishme dhe metoda e amortizimit, rishikohen dhe rregullohen kur është e përshtatshme, në çdo vit financiar. Ndryshimet në metodën e amortizimit do njihen si ndryshime në rregullat e kontabilizimit.

**b. Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata**

Vlera kontabël e aktiveve afatgjata materiale, zvogëlohet deri në shumën e rikuperueshme të aktivitet, nëse kjo shumë është më e ulët se vlera e tij kontabël. Për të përcaktuar nëse një aktiv mund të ketë rënë në vlerë, kryet një test, nëpërmjet të cilit vlerësohet shuma e rikuperueshme.

Një test zhvlerësimi kryhet në çdo date të bilancit për aktivitet që tregojnë shenja të rënies në vlerë. Testi i zhvlerësimit kryhet me qëllim që të përcaktohet shuma e rikuperueshme e një aktivi afatgjatë, e cila është shuma më e lartë midis vlerës së drejtë të një aktivi afatgjatë (minus koston e shitjes) dhe vlerës në përdorim të tij. Vlera kontabël neto e aktivitet reduktohet nëse si vlera e tij e drejtë (minus koston e shitjes) ashtu edhe vlera në përdorim janë më të ulëta se vlera e tij kontabël.

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **b. Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata (vazhdim)**

Nëse ka shenja që shuma e rikuperueshme e nje aktivi afatgjatë është rritur mbi vlerën kontabël, humbja e mëparshme nga zhvlerësimi rimerret dhe vlera kontabël e aktivitetit rritet. Kufiri me i lartë i rritjes është vlera e mëparshme kontabël e aktivitetit afatgjatë minus amortizimin gjatë viteve të ndënjjetme, sikur të mos ishte njohur më pare rënie në vlerë.

Rimarria e një rënie në vlerë njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën raportuese, si një pakësim i humbjes nga zhvlerësimi.

#### **c. Ç'regjistrimi**

Një aktiv afatgjatë material ç'regjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo kur nuk priten më përfitime të ardhurave ekonomike nga përdorimi apo nxjerrja jashtë përdorimit e tij. Çdo fitim ose humbje që vjen nga ç'regjistrimi i aktivitetit (përcaktuar si diferencë mes arkëttimeve të shitjes dhe vlerës së mbetur të aktivitetit) njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur aktivi ç'regjistrohet.

#### **d. Inventarët**

Inventarët maten me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostot e drejtpërdrejta të materialeve përfshijnë, përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjëndjen dhe vendndodhjen ekzistuese. Vlera neto e realizueshme i referohet çmimit të shitjes që Shoqëria pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhën normale të biznesit, minus të gjitha kostot e vlerësuara për ndërlikimin e biznesit.

#### **e. Instrumentat financiarë**

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme dhe të tjera, rnjettet monetare dhe ekuivalentët e tyre dhe llogaritë e pagueshme dhe të tjera. Instrumentat financiarë jo-derivativë maten fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumentat që nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, çdo kosto të transaksioneve që janë direkt të atribueshme, përveç çfarë përkrahëhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare ç'regjistrohen nëse të drejtat kontraktuale të Shoqërisë në rrjedhën e parasë nga aktivitetet financiare skadojnë ose nëse Shoqëria ia transferon aktivitetet financiare një pale tjetër pa ruajtur kontrollin ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit.

Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare rregjistrohen në datën e tregtimit, p.sh. data në të cilën Shoqëria angazhohet të shesë apo të blejë aktivin. Detyrimet financiare ç'regjistrohen nëse detyrimet e Shoqërisë të përcaktuara në kontratë skadojnë ose anulohen.

#### *Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre*

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përbëhen nga vlera në arkë, llogaritë rrjedhëse bankare dhe depozitat bankare me maturitet tre muaj ose me pak nga data e lidhjes së kontratës. Ekuivalentet e parasë përfshijnë investime afatshkurtra, shume likuide, të cilat janë lehtësisht të konvertueshme në para dhe kanë një rrezik minimal, përta i përket ndryshimit të vlerës së drejtë.

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **e. Instrumentat financiarë (vazhdim)**

##### *Llogari dhe kërkesa të arkëtueshme*

Llogaritë dhe kërkesat e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me kosto minus humbje nga zhvlerësimi, nëse ka. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme krijohet kur ka të dhëna objektive që Shoqëria nuk është e aftë të mbledhë të gjitha shumat për t'u arkëtuar sipas kushteve fillestare. Kostoja e amortizuar e llogarive dhe kërkesave të arkëtueshme afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provigjionet e krijuara për rënie në vlerë).

##### *Detyrimet Financiare*

Detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë të shumës për t'u paguar, duke përfshirë detyrimet për interesin e pagueshëm në periudhat e ardhshme, me metodën e normës së interesit efektiv. Detyrimet financiare mbahen në vazhdim me koston e amortizuar.

##### *Metoda e interesit efektiv*

Metoda e interesit efektiv është një metodë për llogaritjen e kostos së amortizuar të një detyrimi financiar dhe e shpërndarjes së shpenzimeve të interesit përgjatë periudhës. Norma efektive e interesit është norma që skanton rrjedhat e ardhshme të pagesave gjatë kohëzgjatjes së parashikuar të detyrimit financiar ose, kur është e përshtatshme, një periudhë më të shkurtër.

##### *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Shoqëria vlerëson në çdo datë të mbylljes së bilancit, nëse ka të dhëna që një aktiv financiar ose grup aktivesh financiare është zhvlerësuar. Nëse rezulton diçka e tillë, atëherë aktivi financiar i mbajtur me koston e amortizuar, zvogëlohet deri në vlerën aktuale të flukseve të përlllogaritura të ardhshme të parasë (të skontuara me normën e interesit efektiv fillestar të aktivitetit financiar). Humbjet nga zhvlerësimi i aktivitetit financiar njihen si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Informacioni objektiv, që një aktiv ose grup aktivesh ka rënë në vlerë, përfshin të dhëna të vëzhgueshme për ngjarje si: vështirësi të mëdha financiare të huamarrësit, mosrespektim i kontratës (p.sh. rasti i dështimit ose i vonesës në pagimin e interesave dhe të principalit); falimentimi dhe ristrukturime të tjera financiare të huamarrësit

Zhvlerësimi i aktiveve financiare, individualisht të rëndësishme, vlerësohet veçmas për secilin aktiv. Aktivitetet financiare, të cilat nuk janë të rëndësishme individualisht dhe për të cilat nuk ka të dhëna për zhvlerësim, vlerësohen në mënyrë kolektive për ndonjë rënie në vlerë.

Humbja nga rënia në vlerë mund të anulohet nëse anulimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi është njohur humbja nga zhvlerësimi. Rimarja e humbjes nga zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### *Çregjistrimi*

Një aktiv financiar ç'regjistrohet kur Shoqëria humbet të drejtën mbi flukset e parave të aktivitetit financiar ose transferon të drejtën për të marre flukset e parave që vijnë nga aktivi financiar në një transaksion në të cilën transferohen gjithashtu edhe të drejtat dhe rreziqet e pronesisë së aktivitetit financiar. Me ç'regjistrimin e një aktiviteti financiar, diferenca mes vlerës kontabël të aktivitetit financiar dhe shumës së arkëtuar për të njihet në fitim ose humbje në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Shoqëria ç'regjiston një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shkarkohen, anulohen ose skadojnë. Një detyrim financiar shkarkohet kur paguhet ose i transferohet me kontratë një pale tjetër.

**3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)****e. Instrumentat financiarë (vazhdim)**

Një detyrim financiar anulohet vetëm nëse pala tjetër e anulon atë. Një detyrim financiar skadon në datat e paraqitura në legjislacionin përkatës. Diferenca mes vlerës kontabël të detyrimit financiar dhe shumës së paguar për të njihet në fitim ose humbje në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

**f. Transaksionet në monedhë të huaj**

Fitimi ose humbja nga konvertimi i zërave monetarë në monedhë të huaj është diferenca që rezulton nga një numër i dhënë njësisht të një monedhe të huaj në Lekë me kurse këmbimi të ndryshëm. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetarë të shprehura në monedhë të huaj përkthehen në Lekë me kursin e këmbimit të datës së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerën e drejtë ripërkthehen në Lekë me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Fitimet ose humbjet që vijnë nga ndryshimet e kursit të këmbimit raportohen neto në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit zyrtarë për monedhat kryesore të përdorura në përkthimin e zërave të bilancit kontabël të cilat shprehen në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë si më poshtë (Leku ndaj kurseve të huaja të këmbimit):

	<b>Dhjetor 31, 2017</b>	<b>Dhjetor 31, 2016</b>
1 EUR	132.95	135.23
1 USD	111.01	128.17

**g. Provigjonet**

Provigjoni njihet nëse si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose strukturor dhe nëse ekziston mundësia që të kërkohet një dalje burimesh e shprehur me përfitimet ekonomike për të shlyer detyrimin, e cila mund vlerësohet në mënyrë të besueshme. Provigjonet përcaktohen duke skontuar rrjedhat e ardhshme të parasë me një normë para tatimit, e cila paraqet vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike që lidhen me atë detyrim.

**h. Të ardhurat dhe shpenzimet**

Të ardhurat nga shitja vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e zbritjeve të ofruara dhe taksave të lidhura me shitjet. Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur Shoqëria i ka kaluar bleresit të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë e mallrave, kur është i mundur kthimi i shumës, kur shpenzimet e bëra në lidhje me transaksionin dhe kthimet e mundshme të mallrave mund të maten me besueshmëri, kur Shoqëria nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në menaxhimin e mallrave dhe shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri. Transferimi zakonisht ndodh kur produkti i kalon klientit në pikën e shitjes. Shoqëria njihet si shpenzim çdo shtesë të rezervave për provigjione kundrejt rreziqeve, humbjeve, dëmtimit fizik ose kthimeve të mundshme që njihen në datën e pasqyrave financiare.

**i. Të ardhura dhe shpenzime financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat mbi fondet e investuara në depozita bankare dhe fitimet nga kursi i këmbimit. E ardhura nga interesi njihet kur ai përfitohet, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **i. Të ardhura dhe shpezime financiare (vazhdim)**

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë e marra, humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktivitetit financiar nëpërmjet fitimit ose humbjes (nëse ka), dhe humbjeve nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Të gjitha kostot e huase njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### **j. Shpenzimi i tatimit mbi fitim**

Tatimi aktual është shuma e pritur e tatimit të pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Shoqëria ka zgjedhur të aplikojë SKK I I "Tatimi mbi fitimin" për njohjen e tatimit të shtyrë.

#### **k. Pagesat e qirasë**

Pagesat e qirasë se operative njihen si shpenzime, duke përdorur metodën lineare përgjatë afatit të qirasë. Pagesat minimale të qirasë financiare ndahen në shpenzime financiare dhe pakësime të detyrimit të mbetur. Shpenzimet financiare shpërndahen gjatë afatit të qirasë me qëllim që të përfitohet një normë interesi periodike e qëndrueshme mbi gjëndjen e mbetur të detyrimit.

#### **l. Adaptimi i SNRF**

SNRF 1 - Adaptimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar përcakton procedurat që një njësi ekonomike duhet të ndjekë kur ajo adapton SNRF për herë të parë si bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme. SNRF lejon përjashtime të kufizuara nga kërkesat e përgjithshme në përputhje me secilin nga SNRF në fuqi në fund të periudhës së raportimit.

Data e tranzicionit të Shoqërisë është data 1 Janar 2014.

### **3.1 PERDORIMI I VLERËSIMEVE KONTABËL**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme, nëse ato ndikohen.

Në veçanti, infonnacioni për elemente të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare përshkruhen në shënimet shpjeguese të mëposhtme.

Përdorimi i supozimeve kontabël është minimal në pasqyrat financiare aktuale duke marrë parasysh thjeshtësinë e natyrës së operacioneve që kryen Shoqëria.

Vlerësimet janë përdorur, por jo të kufizuara, në:

- Jetën e amortizueshme dhe vlerën e mbetur e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale,
- Zbritjen për inventarët dhe borxhet e dyshimta, dhe
- Çështjet ligjore.



**3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

**3.1 PERDORIMI I VLERËSIMEVE KONTABËL**

Ngjarjet e ardhshme dhe ndikimi i tyre nuk mund të perceptohen me siguri. Prandaj, vlerësimet kontabël të bëra kërkojnë ushtrimin e gjykimit dhe gjykimi i përdorur në përparatjen e pasqyrave financiare do të ndryshojë me krijimin e ngjarjeve të reja, me fitimin e përvojës, me martjen e informacioneve shtesë dhe ndryshimin e mjedisit operues të Grupit. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Supozimet kryesore që lidhen me të ardhmen dhe burime të tjera kryesore të vlerësimit të pasigurisë në datën e bilancit, që kane një rrezik të rëndësishëm në rregullimet materiale të vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë diskutuar më poshtë.

#### 4. APLIKIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË REJA DHE TË RISHIKUARA (SNRF)

##### 4.1 STANDARTET DHE INTERPRETIME EFEKTIVE NË PERIU DHËN AKTUALE

Standartet e mëposhtme, të cilat janë kryesisht amendime të standarteve ekzistuese dhe interpretime të nxjerra nga Bordi Ndërkombëtar i Standarteve Kontabël janë efektive për periudhën aktuale.

- **Ndryshimet e SNK 19 “Përfitimet e punonjësve”** – Përcaktimi i planeve të përfitimit: Kontributet e Punonjësve (efektive për periudhat që fillojnë nga 1 Korrik 2014),
- **Ndryshime në standartet e ndryshme “Përmirësimet e SNRF-ve (cikli 2010-2012)”** – Ndryshime që rezultojnë nga rishikimi vjetor që u është bërë SNRF-ve (SNRF 2, SNRF 3, SNRF 8, SNRF 13, SNK 16, SNK 24 dhe SNK 38) kryesisht me qëllim që të shmangen mospërputhjet dhe të qartësohet formulimi i standartit (ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë nga data 1 Korrik 2014),
- **Ndryshime në standartet e ndryshme “Përmirësimet e SNRF-ve (cikli 2011-2013)”** - Ndryshime që rezultojnë nga rishikimi vjetor që u është bërë SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 3, SNRF 13 dhe SNK 40), kryesisht me qëllim që të shmangen mospërputhjet dhe të qartësohet formulimi i standartit (ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë nga data 1 Korrik 2014).
- **Ndryshime në SNRF 12 si pasojë e “Përmirësimeve të SNRF-ve ( cikli 2014-2016)”** rezultuar nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF ( SNRF 1, SNRF 2, dhe SNK 28) kryesisht me një pikëpamje për të eliminuar mospërputhjet dhe për të qartësuar formulimin (ndryshimet mbi SNRF 12 do të jenë të aplikueshme për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017).
- **Ndryshime në SNRF 10 “Pasqyrat financiare të konsoliduara” dhe SNK 28 “Investime në pjesëmarrje dhe sipërmarrje te perbashkëta”**- Shitja apo kontributi i pasurive ndërmjet një investitori dhe bashkëpunetori të tij ose sipërmarrje të përbashkët (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2016),
- **SNRF 14 “Rregullimi i Llogarive të Shtyra”** - (efektive duke filluar 1 Janar 2016 e në vazhdim)
- **Ndryshime në SNK 1 “Paraqitja e pasqyrave financiare”** - Iniciativat e zbulimit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2016),
- **Ndryshimet në SNK 7 “Pasqyra e Fluksit të Parasë”** - Nisma Për Paraqitje (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2017),
- **Ndryshime në SNK 12 “Tatimet mbi të ardhurat”,** - Njohja e aktiveve tatimore të shtyra për Humbjet e Perealizuara (efektive për vjetore periudhat që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2017)
- **Ndryshime në SNK 16 “Prona, Impiantet dhe Pajisjet” dhe SNK 38 “Aktive jo-materiale”** - Sqarim i metodave të pranueshme të zhvleresimit dhe amortizimit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2016),
- **Ndryshime në SNK 16 “Prona, Impiantet dhe Pajisjet” dhe SNK 41 “Agrobiznesi”** - Agrobiznes: Bimët bartesi (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2016),
- **Ndryshime në SNK 27 “Pasqyrat financiare individuale”** - Metoda e kapitalit në pasqyrat financiare individuale (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2016),

#### 4.1 STANDARTET DHE INTERPRETIME EFEKTIVE NË PERIUDHËN AKTUALE (VAZHDIM)

- **Ndryshime në disa standarde “Përmirësimet e SNRF-ve (2012-2014)”** që rezultojnë nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF-ve (SNRF 5, SNRF 7, SNRF13, SNK 19, SNK 34) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e fjalëve (ndryshimet duhet të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2016).

Adaptimi i këtyre ndryshimeve tek standartet ekzistuese nuk ka çuar në ndryshime për sa i përket politikave kontabël të Shoqërisë.

#### 4.2 Standartet dhe interpretimet që nuk janë adoptuar ende

Disa standarte dhe interpretime reja të cilat janë të detyrueshme për t’u zbatuar duke filluar nga 1 Janari 2016 e në vazhdim janë publikuar, të cilat kompania nuk i ka adaptuar ende:

- **SNRF 9 “Instrumentat financiare”** – (efektive për periudhat që fillojnë nga 1 Janari 2018).
- **SNRF 15 “Të ardhura nga Kontratat me Klientët”** dhe ndryshime të mëtejshme (efektive duke filluar 1 Janar 2018 e në vazhdim),
- **SNRF 16 “Qiratë”** (efektive duke filluar 1 Janar 2019 e në vazhdim),
- **Ndryshime në SNRF 10 “Pasqyrat financiare të konsoliduara” dhe SNRF 12 “Dhënia e informacioneve shpjeguese për përfshirje me entitete të tjera” dhe SNK 28 “Investime ne pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta”** - Subjektet e investimeve: Përrjashtim konsolidimi (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2016)

Shoqëria ka vendosur të mos i adaptoje këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. Përveç impaktit të SNRF 9, i cili do të vlerësohet nga kompania gjatë vitit 2016, Shoqëria beson se adaptimi i standarteve të reja, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë në periudhën fillestare të aplikimit.

**5. MJETET MONETARE DHE EKUIVALENTËT E TYRE**

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre janë si më poshtë :

	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
<b>Para në arkë</b>	<b>58,288</b>	<b>31,607</b>
Lek	53,691	28,824
Valutë e huaj	4,597	2,783
<b>Para në bankë</b>	<b>605,659</b>	<b>504,097</b>
Lek	600,742	502,288
Valutë e huaj	4,917	1,809
<b>TOTALI</b>	<b>663,947</b>	<b>535,705</b>

**6. INVENTARI**

Gjëndja e inventarit më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Mallra të përfunduar	282,604	242,232
Provizjione për zhvlerësime	(69,469)	(50,093)
<b>TOTALI</b>	<b>213,135</b>	<b>192,139</b>

Inventari njihet me koston e lëndëve të para dhe mallrave për rishitje dhe paraqitet me vlerën më të vogël midis koston dhe vlerës neto të realizueshme të mallrave të përfunduar. Kostoja e inventarit e njohur si shpenzim përfshin 9,015 mijë Lekë zhvlerësim inventarit në vlerën neto të realizueshme.

	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
<b>Levizjet në zhvlerësim</b>		
Balanca hapëse	(50,093)	(32,669)
Zhvlerësimi i vitit	(19,376)	(17,424)
Rimarrje e provigjonit	-	-
<b>TOTALI</b>	<b>(69,469)</b>	<b>(50,093)</b>

**ITX Albania Sh.p.k.****Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Shumat janë shprehur në mijë LEK)***7. AKTIVE TË TJERA**

Aktivet e tjera më 31 dhjetor 2017 and 2016 përbëhen si me poshtë:

	<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>Më 31 dhjetor 2016</b>
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	-	2,580
Paradhënie për furnitorët	7,666	6,941
<b>TOTALI</b>	<b>7,666</b>	<b>9,521</b>

Shuma e parapagimit të qirasë lidhet me shumat që Shoqëria i ka paguar çdo muaj qiradhënësit për hapësirat e marra me qira. Sipas kontratës, Shoqëria duhet t'i paguajë qiradhënësit një përqindje mbi shitjet vjetore për secilin dyqan. Në fund të vitit kryhet një rregullim në lidhje me shumën e parapaguar dhe shumën e detyruar. Pjesa më e madhe e balancës përbëhet nga parapagimi i bërë për doganën.



**ITX Albania Sh.p.k.**

**Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**  
(*Shumat janë shprehur në mijë LEK*)

**8. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE**

	<b>Mobilje dhe pajisje</b>	<b>Pajisje kompjuterike ambjentve me qira</b>	<b>Përmirësimet e</b>	<b>Asete te tjera</b>	<b>Asete te tjera ne progres</b>	<b>Total</b>
Shtesa	14,035	2,078	660	612		17,385
<b>Si ne 31 Dhjetor 2016</b>	<b>262,355</b>	<b>32,517</b>	<b>787,471</b>	<b>2,863</b>		<b>1,085,206</b>
Shtesa	9,327	10,247	8,610	308	4,678	33,171
<b>Si ne 31 Dhjetor 2017</b>	<b>271,682</b>	<b>42,764</b>	<b>796,081</b>	<b>3,171</b>	<b>4,678</b>	<b>1,118,377</b>
Depreciation charge for the year	25,061	6,648	84,356	320		116,385
<b>Si ne 31 Dhjetor 2016</b>	<b>72,243</b>	<b>17,114</b>	<b>245,386</b>	<b>787</b>		<b>335,530</b>
Depreciation charge for the year	26,502	7,013	75,205	318		109,037
<b>Si ne 31 Dhjetor 2017</b>	<b>98,745</b>	<b>24,127</b>	<b>320,591</b>	<b>1,105</b>		<b>444,567</b>
Vlera e mbetur						
<b>Si ne 31 Dhjetor 2016</b>	<b>190,112</b>	<b>15,403</b>	<b>542,085</b>	<b>2,076</b>		<b>749,676</b>
<b>Si ne 31 Dhjetor 2017</b>	<b>172,938</b>	<b>18,637</b>	<b>475,491</b>	<b>2,066</b>	<b>4,678</b>	<b>673,810</b>

Vlerat që lidhen me përmirësimet të ambienteve qirasë janë kryesisht të lidhura me punët e kryera nga Shoqëria në dyqane me qera, ku kryhet veprimtaria. Mobilje dhe pajisje janë të lidhura me mobilje të reja të blera për dyqane dhe zyra

**9. AKTIVE TE SHTYRA TATIMORE**

Shoqëria ka aktive të shtyra tatimore të lidhura me diferencën që vjen nga aplikimi i normave të ndryshme të amortizimit për qëllime fiskale dhe statutore. Shuma i është zbritur tatim fitimit të vitit. Për detaje të mëtejshme ju lutem shikoni shenimin 17.

	<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>Më 31 dhjetor 2016</b>
Balanca Hapëse	15,808	10,108
Amortizimi sipas normave të grupit	109,037	116,388
Amortizimi sipas normave fiskale	70,721	78,385
<b>Diferencë e përkohëshme</b>	<b>38,316</b>	<b>38,003</b>
Norma e tatimit	15%	15%
<b>TOTALI</b>	<b>21,556</b>	<b>15,808</b>

**10. LLOGARITË E PAGUESHME**

Vlerat e lidhura me llogaritë e pagueshme tregtare janë drejt kompanive të grupit dhe janë të lidhura me blerjen e produkteve të gatshme që Shoqëria ka kryer për aktivitetin e tij.

	<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>Më 31 dhjetor 2016</b>
Industria De Diseno Textil Sa	13,549	29,356
Itx Merken B.V	17,106	16,754
Goa-Invest S.A.	10,415	-
Grupo Massimo Dutti Sa	6,015	2,454
Bershka Bsk Espana Sa	4,497	3,704
Stradivarius Espana Sa	3,406	1,613
Tempe Sa	2,883	5,727
Pull & Bear Espana, S.A.	1,595	2,031
Zara Croatia, L.T.D	227	168
Itxr Macedonia Dooel Skopje	-	781
	<b>59,693</b>	<b>62,558</b>

**11. TË ARDHURAT E SHTYRA**

Të ardhurat e shtyra janë të lidhura me tarifën e hyrjes të paguara nga Tirana East Gate (qiradhënësi), si pjesë e kontratës me kompaninë për dhënie me qira të dyqaneve. Shuma është regjistruar fillimisht si e ardhur shtyrë dhe amortizohet gjatë jetës së qirasë si një zbritje të shpenzimeve vjetore të qirasë. Të ardhurat e shtyra afatshkurtër vs afatgjatë mund të detajohen si më poshtë:

	<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>Më 31 dhjetor 2016</b>
Të ardhura të shtyra afatshkurtra	29,670	29,670
Të ardhura të shtyra afatgjata	304,118	333,789
<b>TOTAL</b>	<b>333,788</b>	<b>363,459</b>

**12. DETYRIME TË TJERA**

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohen si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Tatim fitimi i pagueshëm	18,238	31,220
Taksa të tjera të pagueshme	41,560	35,588
Të pagueshme për shërbimet	76,405	32,639
Detyrime ndaj punonjësve	6,796	8,580
Kreditorë të tjerë	6,469	4,029
<b>TOTALI</b>	<b>149,468</b>	<b>112,056</b>

Të pagueshme për shërbimet përfshijnë shumat e pagueshme më 31 dhjetor 2017 për sigurinë, pastrimin, shërbimet profesionale dhe të tjera që ka përfituar kompania.

**13. TË ARDHURAT NGA SHITJET**

Të ardhurat nga shitjet përbehen si më poshtë :

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shitje veshjesh	2,707,496	2,223,411
Shitje këpucësh	334,979	298,996
Shitje parfumeshe dhe produktesh kozmetike	30,091	27,764
Zbritje për punonjësit	(10,885)	(10,034)
<b>TOTALI</b>	<b>3,061,681</b>	<b>2,540,136</b>

**14. SHPENZIME TE TJERA OPERATIVE**

Shpenzimet e tjera operative përbehen si me poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Qira	(178,601)	(149,148)
Honorare	(189,761)	(122,414)
Shpenzime të tjera operative	(33,965)	(27,858)
Energji elektrike	(31,117)	(33,240)
Shërbime të tjera profesionale	(24,551)	(19,967)
Komisione Bankare	(14,488)	(11,871)
Shërbime ndaj Grupit	(11,366)	(6,742)
Komisione Bankare	(14,488)	(11,871)
Dekorim për dyqanet	(3,718)	(3,808)
<b>TOTALI</b>	<b>(487,566)</b>	<b>(375,048)</b>

Honoraret lidhen me ofrimin e shërbimeve nga ITX Merken B.V në lidhje me zgjerimin, zhvillimin, përsosjen dhe funksionimin e sistemeve, modeleve dhe procedurave, si dhe kryerjen dhe zbatimin e hulumtimeve dhe projekteve në lidhje me krijimin dhe zbatimin e imazhit të korporatave dhe të biznesit.

**15. TË ARDHURA DHE SHPENZIME FINANCIARE**

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga interesi	-	235
Shpenzime interesi	-	-
<b>Të ardhura financiare</b>	<b>-</b>	<b>235</b>
Fitim nga kursi i këmbimit	5,372	5,195
Humbje nga kursi i këmbimit	(9,795)	(7,133)
<b>Shpenzime financiare</b>	<b>(4,423)</b>	<b>(1,938)</b>
<b>Shpenzime financiare neto</b>	<b>(4,423)</b>	<b>(1,938)</b>

**16. SHPENZIME PERSONELI**

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Pagat bruto	(138,422)	(131,775)
Bonuse	(5,002)	(1,793)
Sigurimet shoqërore	(20,718)	(18,337)
<b>Totali</b>	<b>(164,142)</b>	<b>(151,905)</b>

Shoqëria me 31 dhjetor 2017 kishte 234 punonjës (2016: 187).

**17. TATIM MBI FITIMIN**

Tatimi mbi fitimin në Shqipëri është vlerësuar në normën 15% (2016:15%) të të ardhurave të tatueshme. Në vijim është bërë një rakordim i tatimit mbi fitimin.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Fitimi para tatimit	753,199	668,093
Shpenzime të pazbritshme	(58,677)	(58,900)
Fitimi/(Humbja) i tatueshëm	811,876	726,993
Norma e tatim fitimit	15%	15%
<b>Shpenzimi për tatim fitimin</b>	<b>(121,781)</b>	<b>(109,048)</b>
Tatimi i shtyrë	5,747	5,700
<b>Shpenzimi tatim fitimit neto</b>	<b>(116,034)</b>	<b>(103,348)</b>
<b>Norma e tatimit efektiv</b>	<b>15%</b>	<b>16%</b>

Shpenzimet e pazbritshme lidhen me shpenzime që sipas Ligjit Shqiptar nuk mund t'i zbriten llogaritjes së fitimit/humbjes së tatueshme dhe si rjedhojë dhe shpenzimit të tatim fitimit aktual.

**18. PALËT E LIDHURA**

Një transaksion me palët e lidhura është një transferim i burimeve, shërbimeve apo detyrimeve midis palëve të lidhura, pavarësisht nëse është caktuar një cmim. Një palë është e lidhur me një njësi ekonomike nëse kontrollon, kontrollohet nga, ose është nën një kontroll të përbashkët me njësinë ekonomike; ka një interes në njësinë ekonomike që i jep asaj influencë të konsiderueshme mbi njësinë; ose pala ushtron një kontroll të përbashkët mbi njësinë; pala është një pjesëmarrje e njësisë ekonomike; pala është një sipërmarrje e përbashkët në të cilën njësi ekonomike është një sipërnarrës; ose një nga anëtarët e personelit drejtues të njësisë apo të shoqërisë mëmë të saj (duke përfshirë familjarë të afërt të ndonjërit prej individëve të referuar më sipër).

Më poshtë paraqiten palët e lidhura të Shoqërisë dhe balancat përkatëse më 31 dhjetor 2017 dhe 2016:

<b>Pasqyrat e pozicionit financiar</b>	<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>Më 31 dhjetor 2016</b>
<b><i>Llogari të arkëtushme</i></b>		
Itx Merken B.V.		2,580
Zara Croatia, Ltd		
Inditex Montenegro, D.O.O. Podgorica		
<b>Totali aktiveve me palët e lidhura</b>		<b>2,580</b>
<b><i>Llogari të pagueshme – palët e lidhura</i></b>		
Itx Merken B.V.	(17,106)	(16,754)
Industria De Diseno Textil Sa	(13,549)	(29,356)
Goa-Invest S.A.	(10,416)	-
Grupo Massimo Dutti Sa	(6,015)	(2,454)
Bershka Bsk Espana Sa	(4,497)	(3,704)
Stradivarius Espana Sa	(3,406)	(1,613)
Tempe Sa	(2,883)	(5,727)
Pull & Bear Espana, S.A.	(1,595)	(2,031)
Zara Croatia, L.T.D	(226)	(168)
Itxr Macedonia Dooel Skopje	-	(781)
Zara Serbia, D.O.O. Belgrade	-	-
	<b>(59,693)</b>	<b>(62,588)</b>
<b><i>Huamarjet nga palët e lidhura</i></b>		
Itx Financien B.V.	-	-
	-	-
<b>Totali detyrimeve me palët e lidhura</b>	<b>(59,693)</b>	<b>(62,588)</b>
<b><i>Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve</i></b>		
<b><i>Blerje e produkteve për shitje</i></b>		
Industria De Diseno Textil Sa	868,726	638,030
Bershka Bsk Espana Sa	177,835	164,294
Tempe S.A	174,527	159,099
Grupo Massimo Dutti Sa	150,885	125,001
Pull & Bear Espana, S.A.	117,573	100,861
Stradivarius Espana Sa	91,267	76,796
<b>Totali i shpenzimeve me palët e lidhura</b>	<b>1,580,813</b>	<b>1,264,081</b>
<b><i>Të ardhura nga shitja e shërbimeve</i></b>		
Itx Merken B.V	-	(2,580)
Zara Croatia, L.T.D	-	-
Inditex Montenegro, D.O.O. Podgoica	-	-
<b>Totali i të ardhurave nga palët e lidhura</b>	<b>-</b>	<b>(2,580)</b>



## 19. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

## a) Rreziku u likuiditetit

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 dhjetor 2017 është paraqitur si më poshtë:

	Vlera e mbartur	Deri në 3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	Më shumë se 1 vit
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>					
<i>Aktive financiare</i>					
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	663,947	663,947	-	-	-
Aktive të tjera	7,666	6,025	-	1,641	-
<b>Totali</b>	<b>671,613</b>	<b>669,972</b>	<b>-</b>	<b>1,641</b>	<b>-</b>
<i>Detyrime financiare</i>					
Llogari të pagueshme	(59,693)	(59,693)	-	-	-
Detyrime për qiranë financiare	(333,788)	-	-	(29,670)	(304,118)
<b>Totali</b>	<b>(393,481)</b>	<b>(59,693)</b>	<b>-</b>	<b>(29,670)</b>	<b>(304,118)</b>
<b>Pozicioni neto i likuiditetit</b>	<b>278,132</b>	<b>610,279</b>	<b>-</b>	<b>(28,029)</b>	<b>(304,118)</b>

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 dhjetor 2016 është paraqitur si më poshtë:

	Vlera e mbartur	Deri në 3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	Më shumë se 1 vit
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>					
<i>Aktive financiare</i>					
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	535,705	535,705	-	-	-
Aktive të tjera	9,521	-	-	9,521	-
<b>Totali</b>	<b>545,226</b>	<b>535,705</b>	<b>-</b>	<b>9,521</b>	<b>-</b>
<i>Detyrime financiare</i>					
Llogari të pagueshme	(62,588)	(62,588)	-	-	-
Detyrime për qiranë financiare	(363,458)	-	-	(29,670)	(333,788)
<b>Totali</b>	<b>(426,046)</b>	<b>(62,588)</b>	<b>-</b>	<b>(29,670)</b>	<b>(333,788)</b>
<b>Pozicioni neto i likuiditetit</b>	<b>119,180</b>	<b>473,117</b>	<b>-</b>	<b>(20,149)</b>	<b>(333,788)</b>

## 19. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

## b) Rreziku i kursit të këmbimit

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshtë:

	Vlera e mbartur	Euro	Lek
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>			
<i>Aktive Financiare</i>			
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	663,947	9,514	654,433
Aktive të tjera	7,666	-	7,666
<b>Totali</b>	<b>671,613</b>	<b>9,514</b>	<b>662,099</b>
<i>Detyrime financiare</i>			
Llogari të pagueshme	(59,693)	(59,693)	-
Detyrime të tjera	(333,788)	-	(333,788)
<b>Total</b>	<b>(393,481)</b>	<b>(59,693)</b>	<b>(333,788)</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>278,132</b>	<b>(50,179)</b>	<b>328,311</b>

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2016 paraqitet si më poshtë:

	Vlera e mbartur	Euro	Lek
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>			
<i>Aktive Financiare</i>			
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	535,705	13,375	522,330
Aktive të tjera	9,521	2,580	6,941
<b>Totali</b>	<b>545,226</b>	<b>15,955</b>	<b>529,271</b>
<i>Detyrime financiare</i>			
Llogari të pagueshme	(62,588)	(62,588)	-
Detyrime të tjera	(363,458)	-	(363,458)
<b>Total</b>	<b>(426,046)</b>	<b>(62,588)</b>	<b>(363,458)</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>119,180</b>	<b>(46,633)</b>	<b>165,813</b>

*Analiza e ndjeshmërisë ndaj ndryshimit të kurseve të këmbimit*

Analiza e ndjeshmërisë e paraqitur më poshtë është përcaktuar në bazë të ekspozimit në valutë të huaj në datën e raportimit dhe ndryshimeve të përcaktuara të ndodhura në fillim të vitit financiar dhe duke mbajtur konstant gjatë periudhës raportuese.

Më poshtë paraqiten ndikimet e ndryshimeve të kursit të këmbimit mbi fitimin neto, duke mbajtur të pandryshueshëm të gjithë variablat e tjerë.

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
EUR zhvlerësohet me 10%	5,018	4,663
EUR zhvlerësohet me 10%	(5,018)	(4,663)

**19. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

**c) Rreziku i kursit të këmbimit**

Me një rritje prej 10 përqind në kursin e këmbimit të Euros ndaj Lek-ut në datën e raportimit, ndikimi i përgjithshëm në rezultatin financiar të Shoqërisë do të shkaktonte një rritje prej 5,018 Lekë si rezultat i ekspozimit ndaj letrave me vlerë dhe gjendjeve të llogarive afatshkurtra të emëruara në Euro.

Me një ulje prej 10 përqind në kursin e këmbimit të Euros ndaj Lek-ut, ndikimi i përgjithshëm në rezultatin financiar të Shoqërisë do të ulej me 5,018 Lekë.

**d) Rreziku i kredisë**

Shoqëria nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë sepse shuma e llogarive të arkëtueshme është e barabartë me zero.

**20. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË ARDHSHME**

Më 31 Dhjetor 2017 shoqëria ka një marrëveshje qiraje me Tirana East Gate në lidhje me qiranë e dyqaneve me Z. Agim Xhelilaj dhe Znj. Katerina Xhelilaj lidhur me qiranë e zyrave. Pagesat e qirasë janë pagesa fikse dhe pagesa të ndryshueshme. Pagesat fikse varen nga metrat katrorë të dyqaneve, kurse pagesat e ndryshueshme bazohen në përqindjen e shitjeve mujore të dyqanit, sipas kontratës. Nuk ka angazhime dhe detyrime të ardhshme të tjera më 31 Dhjetor 2017.

**21. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT**

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së raportimit, në dhe pas datës 30 mars 2017 që kërkojnë rregullime apo paraqitje shtesë në pasqyrat financiare të Shoqërisë.